

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Gjatë muajit gusht Bordi i ERE-s ka zhvilluar 3 mbledhje, që kanë rezultuar në 14 vendimmarrje, ndër të cilat:

Licencimin e shoqërive:

- 1.“FAETHON” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 93 MW, me vendndodhje në Qarkun Gjirokaštër, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 14.02.2027 dhe me kusht qw shoqwria të raportojë në ERE në çdo 3 muaj, në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve për ndërtimin e parkut fotovoltaiik dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 04.10.2025, që është dhe afati i fundit i vlefshmërisë së Deklaratës Mjedisore.
- 2.“BMC ENERGY SAL” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Qarkun Fier për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 31.03.2025, me kusht qw shoqëria të depozitojë në ERE VNM-në Paraprake të re brenda datës 23.10.2024.
- 3.“ACHELO” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Kotorri, me kapacitet të instaluar 1.9MW, për një afat 30-vjeçar, duke filluar nga data 04.08.2025, me kusht që shoqëria të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 16.11.2027.
- 4.“SUN’S MIRACLE” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2MW, në Qarkun Fier, për një afat 30-vjeçar duke filluar ky afat nga data 15.09.2024.
- 5.“Nova Prospect” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, Qarku Vlorë, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 30.08.2024. me kushtin që shoqëria të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për njoftimin e bërë nga ana e saj për ndryshimin e vlerës së investimit të projektit.

Në këtë gazetë do të lexoni mbi

Licencime të muajit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

Fillime të procedurave për licencim

Rinovime të licencave

Tarifa dhe çmime

Plotësim të kushteve

Aktivitete

Seanca dëgjimore dhe konsultime

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërive

- “MAGNA SOLAR POWER” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Qarkun Fier. Pranimin e kërkesës së shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” shpk për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “STAVEC” nga 6,520 MW në 8,44 MW dhe fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 04.11.2020.
- “HPG ENERGY” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2MW dhe veprave ndihmëse, me vendndodhje në Bashkinë Fier.

Rinovimin e licencës së shoqërive

- “NOA ENERGY TRADE” sh.pk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 07, datë 02.02.2015, rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 20.12.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.02.2025.
- “FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL” sh.a në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, rinovuar sërish me vendimin nr. 164, datë 04.11.2019, për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 22.12.2024.

Vendime në lidhje me zgjatjen e vendimmarrjes, plotësimet e kushteve të paravendosura dhe kërkesa të ardhura nga subjekte të licencuara

- Zgjatjen deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “BMG ENERGY SAL” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Shfuqizimin e pikave 2 dhe 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024 "Mbi licencimin e shoqërisë “5GX ENERGY” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si rezultat i plotësimit të kushteve të paravendosura.
- Pranimin e kërkesës së shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” shpk për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC “STAVEC” nga 6,520 MW në 8,44 MW dhe fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së kësaj të fundit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Stavec”, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 04.11.2020.

Seanca dëgjimore

Pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe 3 seanca dëgjimore të zhvilluara për zgjidhjen e ankesave dhe marrjen e qëndrimeve të palëve, si dhe me subjekte të licencuara, me qëllim sqarimin e paqartësive dhe për të rezultuar me një vendimarrje më të plotë.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

ERE është përgjegjëse për zhvillimin e metodologjive të tarifave dhe çmimeve për aktivitetet e rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe bazuar në analizat e saj propozon përmirësime të metodologjive ekzistuese.

Sa i përket kësaj fushe përgjegjësie, gjatë muajit gusht janë marrë vendime mbi:

- 1.Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2024 prej 19.79 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
- 2.Disa ndryshime në vendimet e Bordit të ERE-s Nr. 287/2023 dhe Nr. 102/2024, si më poshtë:
 - a.Ndryshimin e pikës 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 287, datë 09.10.2023, të ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 50, datë 02.04.2024, mbi miratimin e “Listës së Tarifave të ALPEX” të cilat do jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), deri më 31.12.2024. (Tabela bashkëlidhur).

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Një herë	7,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Një herë	5,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	2,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh	Transaksion	0.070 €	Anëtar i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	Transaksion	0.020 €	Anëtar i Bursës
Tarifa e Tregtimit në Emër të Dikujt Tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtar i Bursës
Tarifa për API Përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtar i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtar i Klerimit
Tarifa vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për përdorues	Vjetore	50 €	Anëtar i Bursës / Anëtar i Klerimit

- Për tregun e Shqipërisë të gjitha tarifat do të shlyen në monedhën Euro për jo-rezidentët.
- Për tregun e Shqipërisë të gjitha tarifat fikse do të shlyen në monedhën Lekë, ekuivalent të referencës së përcaktuar në monedhën EURO, për rezidentët.
- Mbi tarifat do të aplikohet TVSH-ja.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

b. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 102, datë 27.05.2024, mbi miratimin e pjesshëm të kërkesës së ALPEX sh.a. për miratimin e “Listës së Tarifave për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë”, të cilat do jenë të aplikueshme deri me 31.12.2024 për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO). (Lista bashkëlidhur)

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Vjetore	8,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.140 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.040 €	Anëtari i Bursës

- (a) Për tregun e Shqipërisë Tarifat Fikse do të shlyhen në monedhën Euro për jo-rezidentët
(b) Për tregun e Shqipërisë Tarifat Fikse do të shlyhen në monedhën Lekë.
(c) Mbi çdo tarifë do të aplikohet TVSH-ja.

Aktivitete

Vizita në Parkun Eolik në Katuni Kroaci

Vizita në Parkun Eolik në Katuni Kroaci, pjesë e axhendës për dekarbonizimin e sektorik elektrik në Ballkanin Perëndimor, u zhvillua si bashkëpunim mes përfaqësive të organizatës GIZ në Ballkan, ndër të cilat dhe GIZ Albania. ERE u përfaqësua nga Drejtori i Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve, z. Bledar Qira, i cili e cilësoi këtë vizitë në terren por dhe shkëmbimin e eksperiencës me vendet e rajonit, si një udhërrëfyes për të gjithë projektet e së ardhems që synojnë prodhimin e energjisë nga kjo kategori burimi të rinovueshëm në Shqipëri.

Anëtarësimi i Kosovës në AIB

Gjatë një takimi të përbashkët në ambjentet e ERE-s, ku morën pjesë dhe shkëmbyen eksperiencat e tyre, dhe përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energjinë në Kosovë dhe LuxDev - Agjensia e Bashkëpunimit për Zhvillim të Luksemburgut, palët pjesmarrëse shprehën suportin për përfshirjen e ZRRE në AIB - Shoqatën e lëshuesve të garancive të origjinës, duke promovuar kështu standardizimin e përdorimit të Sistemit të Certifikimit European të Energjisë. ERE është anëtare e AIB me të drejta të plota që prej majit 2024.

Duke shfletuar faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al, mund të njiheni me të dhënat e fundit të [tregut të energjisë në vend](#), regjistrat e [licencimit të subjekteve](#), [të garancive të origjinës](#) dhe të [ankesave të rifreskuar](#), si dhe [tarifa dhe çmime](#) të miratuara nga ERE. Për tu njohur me këto vendime dhe të tjera, në mënyrë më të detajuar, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al në kategorinë [vendime](#).